2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

-Vertetim nga Dega e Tatim Taksave per xhiron vjetore te realizuar ne 3 (tre) vitet e fundit ku vlera mesatare e tyre te jete jo me te ulet se 50 % e fondit limit te lotit apo lotëve qe ofertuesi konkurron.

-Nje certifikate te gjendjes financiare nga nje ose me shume banka ku vertetohet se ka gjendje nje shume jo me te ulet se 10 % e fondit limit te lotit apo loteve qe ofertuesi konkurron.

2.3 Kapaciteti teknik:

-Furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit në një vlerë prej 40% e vleres qe prokurohet, e realizuar gjate tre viteve te fundit te cilat vërtetohen me:

- Kontrata te ngjashme te shoqeruara me vertetim realizimi te saj të marrësit të mallit Ose/ dhe faturave tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të e mallrave të furnizuara te firmosura nga bleresi.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm faturat tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të e mallrave të furnizuara te firmosura nga bleresi .

- Operatori ofertues duhet të jetë i pajisur me autorizim prodhuesi për mirëmbajtjen e pajisjeve dhe për furnizimin me pjesë këmbimi

- Operatori të ketë të paktën 2 inxhinierë me të paktën 5 vjet eksperiencë për mirëmbajtjen e aparaturave objekt te këtij prokurimi. Për këtë duhet të paraqiten CV e specialistëve dhe

çertifikatat/dëshmitë e trajnimit lëshuar nga kompania prodhuese ose institucione të autorizuar/certifikuara prej saj, ose nga ndërmarrje/ ente të treta të certifikuara me ISO 13485.

-Inxhinierët të kenë marrëdhënie kontraktuale me ofertuesin. Kjo të vërtetohet duke paraqitur kontratën e lidhur mes tyre.

- Deklaratë nga ana e operatorit ekonomik për garancinë e riparimeve dhe shërbimeve.

- Operatori duhet të paraqesë: Një plan të detajuar që tregon kohën dhe metodat e reagimit dhe ndërhyrjes për të kufizuar sa më shumë të jetë e mundur problemet e shkaktuara nga prishja e pajisjeve

-Per pajisjet e perfshira ne sherbimin full-risk:

1. Një deklaratë që merr përsipër kryerjen e mirëmbajtjes të tipit Full Risk
2. Nje deklarate që merr përsipër zëvendësimin e pjesëve të këmbimit dhe konsumit, që ato do jenë të reja dhe origjinale dhe në përputhje me ato të përdorura fillimisht (te garantuara nepermjet certifikimit CE) dhe që përfshihen në vlerën e kontratës dhe se garancia e pjesëve të këmbimit do të jetë për një periudhë jo më pak se një vit nga momenti i lëvrimit;
3. Një deklaratë që pranon oraret e kryerjes së shërbimeve dhe shpejtësinë e ndërhyrjeve
4. Planin e veprimeve të mirëmbajtjes parandaluese që ofertuesi do të ndërmarrë, për secilin grup pajisjesh, ku të përcaktohen periodiciteti, procedurat operative dhe protokollat që do të përdorë përfshirë kalibrimet dhe testimet periodike të sigurisë elektrike dhe mekanike të pajisjeve në përputhje me standartet përkatëse evropiane

Public Health Sector

- Per pajisjet e perfshira ne sherbimin mirembajtje parandaluese, ne planin e detajuar duhet te listohen te gjitha sherbimet per mirembajtje parandaluese per aparaturat e anestezise dhe respiratore te paraqiten lista e detajuar e kitit te mirembajtjes sipas manualeve ose udhezime te prodhuesit ku parashikohen keto nderhyrje.

- Operatori duhet te paraqese nje liste te pajisjeve testuese dhe kalibruese (nese parashikohen nga prodhuesi) qe do te perdore ne kryerjen e sherbimeve

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 9


[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË MBI GJENDJEN GJYQËSORE

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilesinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj se:

- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, që lidhet me aktivitetin profesional.



Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqesuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 10

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Specifikimet teknike

- 1.Operatori ekonomik është i detyruar të kryejë furnizimin , vendosjen , riparimin e aparaturave mjekesore (të specifikuara në dokumentet e tenderit) dhe aksesoreve të tyre , sipas loteve , brenda standarteve ndërkombëtare dhe në përputhje me teknologjinë aktuale që disponon Autoriteti Kontraktor.
- 2.Operatori ekonomik , pas përfundimit të furnizimit, vendosjes dhe riparimit të çdo aparature mjekesore është i detyruar të dorëzojë pranë Zyres së Inxhinierisë Klinike një informacion të detajuar mbi punën e kryerë si dhe pjesët e zëvendësuesave . Informacioni të jete i firmosur nga inxhinieri që ka kryer punimet, nga titullari i firmës , si dhe të jete i vërtetuesur. Specialisti që do të kryejë riparimet , shërbimet do të ketë eksperiencë në fushën e aparaturave mjekesore me shumë se 3 vjet .
- 3.Proces- verbali të jete i firmosur nga ana e Spitalit Rajonal Elbasan nga përfaqësuesi i Spitalit që do të ndjekë këtë kontratë , kurse për riparimet shërbimet do të firmoset edhe nga Shefi i klinikës/shërbimit ku ndodhet aparatura.
- 4.Periudha e garancisë për riparimet dhe shërbimet do të jete deri në përfundim të kontratës.
- 5.Garancia fillon nga data e dorëzimit të proces-verbalit me shkrim nga operatori ekonomik mbi përfundimin e furnizimit , vendosjes , riparimit, testimi, kolaudim dhe vënie në punë të aparaturave mjekesore me pjesët e reja dhe të dorëzimit të fletës palosjes shoqëruese të pjesës.
- 6.Pjesët e furnizuara të këne shënjën CE.
- 7.Specialisti që do të kryejë punimet /shërbimet për aparaturat me Autorizim prodhuesi duhet të jete i specializuar nga prodhuesit e aparaturave për aparaturat përkatëse në listë.
- 8.Organizimi , realizimi, dokumentacioni i mirëmbajtjes së aparaturave mjekesore do të realizohet në përputhje me Urdhër Nr.3272 Prot. , Datë 11.09.2007 të Ministrit të Shëndetësisë , me objekt: “Miratimi i Politikës Kombëtare për Menaxhimin e Pajisjeve Mjekesore në Shqipëri”.
- 9.Afati i levrimit të shërbimeve për mirëmbajtjen full-risk menjëherë pas lidhjes së kontratës.

1. **Mirëmbajtja parandaluese;** ky shërbim të kryhet në përputhje me rekomandimet e prodhuesit përkatës të pajisjes për të parandaluar defektet që lidhen me përdorimin e pajisjeve dhe pjesëve përbërëse, për të ruajtur pajisjet në gjendjen e duhur të funksionimit, për të siguruar cilësinë dhe besueshmërinë e rezultateve të çdo pajisjeje, për të evidentuar gjendjen e pajisjes si vjetërimi apo përkeqësimi i performancës së pajisjeve.
Ndërhyrjet do të kryhen nga i Kontraktuari, sipas procedurave dhe udhëzimeve teknike të përcaktuara nga prodhuesi për atë lloj pajisje.
Ofertuesi duhet të paraqesë:

***Rekomandimet nga prodhuesi i pajisjes dhe
Një plan veprimesh të mirëmbajtjes parandaluese që përcakton periodicitetin dhe
procedurat operative dhe protokollet që synon të përdorë përfshirë kalibrimet, setet
dhe kitet e mirëmbajtjeve parandaluese dhe pjeset apo aksesore të parashikuara
nga prodhuesi.***

2. Mirëmbajtja korigjuese

Ndërhyrjet e mirëmbajtjes korigjuese do të konsistojnë në përcaktimin e pranisë së një defekti ose mosfunksioni, në identifikimin e shkaqeve, në eliminimin e shkaqeve dhe rivendosjen e karakteristikave origjinale, në verifikimin e integritetit të pajisjes, të funksionimit dhe në kontrollin e sigurisë. Ky shërbim do të përfshijë edhe lëvizjen, spostimin, çmontimin dhe rimontimin e pjesëve të pajisjes gjatë mirëmbajtjes dhe kalibrimit.

Ofertuesi duhet të paraqesë: ***Një plan veprimesh që synon të ndërmarrë për organizimin e mirëmbajtjes korigjuese.***

3. Kalibrimi dhe pajisjet e nevojshme për kryerjen e tij sipas rekomandimeve të prodhuesit.

4. Testimi periodik i sigurisë elektrike dhe mekanike të pajisjeve në përputhje me udhëzimet teknike evropiane dhe ndërhyrjet e nevojshme individuale sipas pajisjes për të siguruar konformitet me rregulloret përkatëse. Ndërhyrjet duhet të synojnë nxjerrjen në pah të të gjitha situatat e rrezikut të mundshëm dhe të identifikojnë veprimet korigjuese me qëllim rritjen e nivelit të sigurisë së spitalit, duke marrë parasysh kushtet specifike mjedisore dhe operative në të cilat ato operojnë me pajisjet dhe karakteristikat individuale të projektimit dhe ndërtimit të tyre, duke iu referuar periudhës së vendosjes së tyre në treg.

Ofertuesi duhet të paraqesë: ***Planin operacional të testimit periodik të sigurisë elektrike dhe mekanike si dhe Udhëzimet përkatëse evropiane në bazë të të cilave ka hartuar planin e tij për kryerjen e këtij shërbimi.***

Në lidhje me çdo mospërputhje të zbuluar gjatë zbatimit të kontrolleve dhe sipas nivelit të rrezikut të identifikuar, I Kontraktuari do të paraqesë raport të hollësishëm teknik tek Kontraktuesi. Ndërhyrjet e nevojshme do të sigurojnë eliminimin e të gjitha moskonformiteteve të konstatuara në pajisje dhe pjesën e ushqimit. Këto ndërhyrje janë në ngarkim të Të Kontraktuarit dhe përfshihen në vlerën e kontratës.

Përveç afateve të përcaktuara në kalendarin e verifikimit periodik, shërbimi i verifikimit të sigurisë së përmendura në këtë pikë duhet të parashikohet edhe ***pas mirëmbajtjes korigjuese***, kur është e zbatueshme.

Kontraktuesi ka të drejtë të kërkojë verifikime përveç atyre të planifikuara, në raste të veçanta, në kushte apo sipas nevojave të veçanta.

Ofertuesi duhet të lëshojë një: ***Deklaratë që merr përsipër sigurimin teknik të stafit të tij gjatë kohës së punës në spital dhe se spitali nuk mban asnjë përgjegjësi për***

aksidentet e ndodhura punonjësve të kompanisë në ambientet e tij.

5. Pjesët përbërëse të sistemit, të këmbimit, përdorimit dhe konsumit

Te gjitha pjesët e këmbimit dhe konsumit të mëposhtme janë në ngarkim të të Kontraktuarit dhe përfshihen në vlerën e kontratës:

- Të gjitha pjesët e këmbimit që mund të lindin nevojat të zëvendësohen kur difektohen, me qëllim mirëfunksionimin e pajisjes.
I Kontraktuari duhet të parashikojë blerjen dhe zëvendësimin e të gjitha pjesëve dhe materialeve të këmbimit gjatë kryerjes së shërbimeve me shpenzimet e tij. Materialet dhe pjesët e këmbimit duhet të jenë të reja, origjinale dhe gjithmonë në përputhje me ato të përdorura fillimisht në pajisje, në përputhje me Direktivën KE 93/42 duke siguruar konformitetin me udhëzimet e dhëna nga prodhuesi në dokumentacionin teknik furnizuar me pajisjen. Ofertuesi duhet të paraqesë dokumenta që vërtetojnë marrëdhëniet e operatorit me kompanitë prodhuese perkatese:
- Te gjitha pjesët e difektuara do të ruhen në magazinën e spitalit rajonal elbasan duke mbajtur edhe një proces-verbal perkates, për çdo rast.

Orari dhe vendet e kryerjes së shërbimeve

Personeli teknik i Të Kontraktuarit do të garantojnë mbulimin e shërbimit për 9 muaj në vit, me përjashtim të festave zyrtare, nga e hëna në të premte me orë 08:00-16:00 dhe të shtunën 8:00-14:00. Këto mund të jenë objekt ndryshimesh në varësi të nevojave specifike të Kontraktuesit.

I Kontraktuari do të sigurojë realizimin e aktiviteteve të përcaktuara në kontratë edhe në rast greve apo konfliktesh sindikaliste apo ngjarje të tjera të paparashikueshme. I Kontraktuari do të caktojë një person kontakti për raportimin e defekteve dhe kontaktet të tjera.

Emri i personit të kontaktit ***të deklarohet në dokumentat e ofertes.***

Shpejtësia e ndërhyrjeve

I Kontraktuari do të duhet të regjistrojë çdo thirrje me qëllim gjurmimin e fillimit dhe mbarimit të çdo ndërhyrje.

Njoftimi për defektet do të kryhet ***me telefon dhe email.***

I Kontraktuari do të sigurojë ndërhyrjen ***brenda ditës së punës***

Kohëzgjatja maksimale e riparimit të defektit do të jetë jo më shumë se 24 orë kur pajisja nuk ka nevojë për pjesë këmbimi dhe ***5 ditë zyrtare pune kur kërkohet zëvendësimi i pjesëve të këmbimit.***

I Kontraktuari duhet të sigurojë që pajisjet të mos qëndrojnë i difektuar për më shumë se ***10 ditë zyrtare pune në vit.***

Operatori duhet të paraqesë: ***Një plan të detajuar që tregon kohën dhe metodat e reagimit dhe ndërhyrjes për të kufizuar sa më shumë të jetë e mundur problemet e shkaktuara nga prishja e pajisjeve si dhe një Deklaratë që pranon Oraret e kryerjes së shërbimeve dhe Shpejtësinë e ndërhyrjeve***

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:



Shtojca 11

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Per lotin 1 Mirembajtje full-risk per pajisje laborator

Nr	Emertimi	Prodhuesi/modeli	sherbimi	Njesia/matjes	sasia
1	Cell-Counter	Avantor/Benesphera H32	Laborator Spital & Poliklinike	cope	2
2	Fotometer	Cypress Diagnostics/Cyanstart	Laborator Spital	cope	1
3	Analizator Biokimik	AMS Analyzer/ SAT 450	Laborator Spital	cope	1
4	Elektrolitmeter	I-sens inc/ I-smart 30pro	Laborator Spital & Poliklinike	cope	2
5	I-chroma reader	Boditech / Ichroma	Laborator Spital & Poliklinike	cope	2
6	Analizator Biokimik	Chemray 240 /Rayto Life&Sci.	Laborator Poliklinike	cope	1
7	Analizator Imunologjik	Snibe Co.Ltd/ Maglumi 800	Laborator Spital	cope	1

Per lotin 2 Mirembajtje full-risk per aparat grafie

Nr	Emertimi	Prodhuesi/ Modeli	sherbimi	Njesia/matjes	sasia
1	Aparat grafi/Skopi	Philips Healthcare/ Duodiagnost	Radiologji Poliklinike	cope	1

Per lotin 3 Mirembajtje parandaluese per aparate anestezie dhe respirator

nr	Emertimi	Prodhuesi/Modeli	Sherbimi	Njesia/matjes	sasia
1	Aparat anestezie	Medec Benelux/ Neptune	Salla operacioni Urgj.Kirurgji/Obs-	cope	3

			Gjin./ORL		
2	Respirator	Carefusion / iX5	Terapia Intensive Kirurgji	cope	1

Per lotin 4 Mirembajtje parandaluese per aparate anestezie dhe respirator

nr	Emertimi	Prodhesi/Modeli	Sherbimi	Njesia/matjes	sasia
1	Aparat anestezie	Drager/Fabius	Salla operacioni Planifikim Kirurgji	cope	1
2	Respirator	Drager / Savina	Terapia Intensive Kirurgji	cope	1

Per lotin 5 Mirembajtje parandaluese per aparat Mamografi dhe anestezi

nr	Emertimi	Prodhesi/Modeli	Sherbimi	Njesia/matjes	sasia
1	Aparat Mamografie	Ims Internacionale/Giotto Image	Radiologji Spital	cope	1
2	Aparat anestezie	Dameca / Siesta Whispa	Salla operacion planifikime	cope	1

Afatet e lëvrimit I per mirembajtjen eshte menjehere pas lidhjes se kontrates.

Shtojca12

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër]

PLANIFIKIMI I KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR

☐ Shërbim: ☐ Mall: ☐ Punë:		
Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01	_____	_____
02	_____	_____
03	_____	_____
...	_____	_____

Shtojca 13

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR¹ Public Health Sector

[vendi dhe data] _____

[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006, Për Prokurimet Publike.

¹ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< Emri >



Shtojca 14

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët ☐ oferta ekonomikisht më e favorshme ☐

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *[emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]* se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej *[shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*/pikët totale të marra *[_____]* është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit]* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____



[Drejtuesi i autoritetit kontraktor]

Shtojca 15

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët ☐ oferta ekonomikisht më e favorshme ☐

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyt e mëposhtme:


* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it*
Vlera _____ / Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it*
Vlera _____ / Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____



Public Health Sector

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Drejtuesi i autoritetit kontraktor]

Shtojca 16

KUSHTET E PËRGJITHSHME Mallrat –Kërkesë për propozim

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokuruar me anë të procedurës kërkesë për propozim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

“kontratë” do të thotë marrveshja e shkruar e lidhur midis Entit prokurues dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

“çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.

“Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë shpërndarjen e funksioneve, kostot, dhe rrisqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktor.

“ Lëvrimi ” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi,

tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.

“Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.

“Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.

“palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.

“Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gazshme.

“Shërbimet në Lidhje me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.

“objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet në Lidhje me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.

“Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikë e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në kofidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t'i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nën-Kontraktuesin një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetin Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i parashtrijë Autoriteti Kontraktues të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikën, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake më shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktor nga mospërgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose shpërndarja e Mallrave sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i Mallrave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Mallrave

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktuesi mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, "origjinë" do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, ose prodhuar. Materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.

- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e Kontraktuesit ose nenkontraktuesit që siguron materialet.

Neni 8: Qëllimi i Furnizimit dhe Pershtatshmeria e Mallrave me Specifikimet

- 8.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat me cilësi, sasi dhe lloj të specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 8.2 Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën, nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin e posaçëm të parashikuar në kontratë. Kur nuk është e mundur të përcaktohet një gjë e tillë, thuhet se Mallrat nuk janë në pajtim me kontratën nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin për të cilin shërbejnë zakonisht sendet e tjera të të njëjtit lloj.
- 8.3 Nëse shitja është bërë në bazë të një modeli ose kampioni, shitësi (Kontraktuesi) duhet të dorëzojë sendet që kanë të njëjtat cilësi si të modelit ose kampionit.

Neni 9: Pershtatshmeria e Mallrave me Standartet Teknike

- 9.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standarteve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë egzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet perkatese ose në Standartet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktues.
- 9.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë dispozitë tjetër të kontratës, kur nuk është përcaktuar asnjë Standart Teknik perkates në specifikimet teknike, Mallrat duhet të jenë konform Standarteve Teknike ndërkombëtare të tanishme. Nëse nuk egzistojnë Standarte Teknike ndërkombëtare, Mallrat duhet të jenë konform Standarteve Teknike perkatese Shqiptare.
- 9.3 Kontraktuesi nuk do të jetë përgjegjës për gabime në skicim, të dhëna, vizatim ose çdo aspekt tjetër të specifikimeve teknike të dhëna nga Autoriteti Kontraktues me përjashtim të rastit kur gabimi ishte aq i dukshëm sa Kontraktuesi duhet ta kishte parë dhe këshilluar Autoritetin Kontraktor për të.
- 9.4 Shitësi (Kontraktuesi) nuk mban përgjegjësi për defekte të pronës (Mallrave) për të cilat Autoriteti Kontraktor ishte në dijeni në momentin e lidhjes së kontratës ose nuk ishte në dijeni për faj të tij, me përjashtim të rastit kur defektet kanë të bëjnë me cilësinë e Mallrave të specifikuar sipas kontratës ose perfaqsimin e reklames së shitësit (Kontraktuesit).

Neni 10: Pjesët e Këmbimit

- 10.1 Nëse kontrata parashikon, Kontraktuesi duhet të përfshijë me Mallrat e dhëna një sasi pjesësh këmbimi, në akordim me specifikimet teknike dhe çdo dispozitë perkatese të kontratës.
- 10.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, pjesët e këmbimit do të dorëzohen bashkë me Mallrat.

- 10.3 Kontraktuesi duhet të garantojë disponueshmërinë e pjesëve të këmbimit për një periudhë të specifikuar në oferten e tij dhe të barabartë me jetgjatësinë e përdorimit të Mallrave.
- 10.4 Në rast të një vendimi të ndërprerjes së prodhimit të pjesëve të këmbimit, Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor në kohë të mjaftueshme për të lejuar Autoritetin Kontraktor të prokurojë sasi të mjaftueshme për përdorim të mëvonshëm.
- 10.5 Pas ndërprerjes së prodhimit të pjesëve të këmbimit, Kontraktuesi duhet t'i japi gratis Autoriteti Kontraktor nëse ai kërkon, çdo prodhim, vegël, skicim të pjesëve të këmbimit të përdorura në prodhimin dhe mirmbajtjen e Mallrave.

Neni 11: Ambalazhimi

- 11.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat të vendosura dhe të ambalazuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 11.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë nen tjetër i kontratës, mund të thuhet se Mallrat nuk janë vendosur dhe pakeluar në pajtim me kontratën nëse ato nuk janë vendosur dhe pakeluar në të njëjtën mënyrë që bëhet zakonisht për gjërat e të njëjtit lloj ose, nëse mënyra e zakonshme nuk është e disponueshme, në një mënyrë që është e përshtatshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e Mallrave.

Neni 12: Testimet dhe Inspektimet

- 12.1 Kontraktuesi duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga Kontraktuesi brenda kushteve të çmimit të kontratës.
- 12.2 Me shpenzimet e tij, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të ndjekë testimet dhe/ose inspektimet.
- 12.3 Autoriteti Kontraktor gjithashtu mund t'i kërkojë Kontraktuesit të bëjë teste ose inspektime shtesë të paparashikuara në kontratë por të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se Mallrat janë konform specifikimeve dhe kushteve të kontratës. Autoriteti kontraktor do të mbajë përgjegjësi për koston e këtyre testeve. Më tej, nëse këto teste ndalojnë progresin e punës së Kontraktuesit, Autoriteti Kontraktor do të bie dakort të ndryshojë grafikun e levrimit.
- 12.4 Autoriteti Kontraktor do të refuzojë çdo Mall që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.
- 12.5 As ekzekutimi i testeve as inspektimi i Mallrave nuk do ta clirojë Kontraktuesin nga çdo garanci ose detyrim tjetër sipas kontratës.

Neni 13: Kushtet e Dorëzimit

- 13.1 Kontraktuesi është i detyruar të kryejë të gjitha aktivitetet dhe veprimet e dorëzimit me përjashtim kur Kontraktuesi përjashtohet në mënyrë specifike nga një aktivitet ose veprim i tillë nga ndonjë dispozitë e kontratës. Nëse një Incoterm përdoret për të përshkruar detyrimet e palëve, termi do të ketë kuptimin që i ka dhënë botimi i fundit i *Incotermave* botuar nga Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.
- 13.2 Vendi i dorëzimit të Mallrave do të jetë sipas specifikimit të kontratës.
- 13.3 Koha e dorëzimit të Mallrave dhe data e përfundimit të Shërbimeve në Lidhje me to do të jetë sipas specifikimit në kontratë.
- 13.4 Dorëzimi i Mallrave duhet të bëhet gjatë orarit të punës me përjashtim kur kjo kërkesë bie ndesh me ndonjë dispozitë të kontratës.
- 13.5 Kontraktuesi është i detyruar t'i japi Autoriteti Kontraktor njoftim të arsyeshëm për dorëzimin e Mallrave përpara arritjes së tyre.

Neni 14 Transportimi i Mallrave

- 14.1 Kontraktuesi është i detyruar të sigurojë ngarkimin dhe transportimin e Mallrave siç kërkohet me qëllim që të plotësojë afatet dhe kushtet e dorëzimit të specifikuara në kontratë.
- 14.2 Nëse Autoriteti Kontraktor është i detyruar të marri Mallrat nga ndonjë mjet transporti apo agjenci transporti, Kontraktuesi duhet të japë lajmërim paraprak të arsyeshëm për transportin dhe t'i japi Autoritetit Kontraktor të gjitha dokumentat e nevojshme për marrjen e Mallrave.
- 14.3 Nëse shitësi, [Kontraktuesi] është i detyruar t'i dorëzojë mallrat në mjetin e transportit në një vend të specifikuar në kontratë, rrishtu i humbjes kalon tek Autoriteti Kontraktor vetëm kur mallrat i dorëzohen mjetit të transportit në vendin e specifikuar. Fakti se shitësi [Kontraktuesi] është i autorizuar të mbajë dokumentat përfaqësuese të mallrave nuk influencon në kalimin e rrishtit.

Neni 15: Siguracioni

- 15.1 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, Kontraktuesi duhet të sigurojë se Mallrat që do dorëzohen sipas kontratës janë plotësisht të siguruara ndaj humbjes ose dëmtimit gjatë transportit, magazinimit ose dorëzimit të tyre.

Neni 16: Ekzaminimi dhe Pranimi i Mallrave

